



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0954

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Auto Europa Cars SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare të MMPHI-së me numër të prokurimit 210-25-4970-2-1-1, me 19/11/2025, mori:

Vendim

1. Refuzohet, si e pa bazuar ankesa e OE Auto Europa Cars SH.P.K. me nr. 2025/0954, e datës 25/09/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare të MMPHI-së me numër të prokurimit 210-25-4970-2-1-1, ndërsa (AK) Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës i lejohej të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit.

2. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 05.06.2025 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare të MMPHI-së me numër të prokurimit 210-25-4970-2-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë me kuotim, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 300,000.00 €.

Me 10.09.2025, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku është rekomanduar për kontratë OE Gani B. Krasniqi B.I.

Me 13.09.2025, OE Auto Europa Cars SH.P.K., ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 16.09.2025.

Me 25.09.2025, OE Auto Europa Cars SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/0954, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e Operatorit Ekonomik Auto Europa Cars SH.P.K., lidhur me ankesën 0954/2025:

Neni 1 Qëllimi Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes Neni 59 Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi i tenderëve Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë Neni 4 Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit I RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar).

Auto Europa Cars sh.p.k. & N.T.SH. EUROPA-Bastri Ademi B.I. ka marr pjesë në aktivitetin e prokurimit të cekuar më lartë dhe më 10.09.2025 kemi pranuar Njoftimin Mbi Vendimin e AK-së ku jemi eliminuar nga aktiviteti i prokurimit e që konsiderojm dhe vlerësojm që është i pa drejtë. PRETENDIM ANKIMORE 1 Në Letren standarde për tenderuesin e eliminuar ceket citoj:

Ne e kundërshtojm fuqishëm eliminimin tonë pasi që AK-ja nuk e ka ekzaminuar vlerësuar dhe krahasuar në këtë rast liten e kontratave dhe referencave. Në dosje të tenderit të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses se paku 1 kontratë për shërbime të njehta, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë) minimum 400,000.00 euro Dëshmia e kërkuar dokumentare 1. Një listë të kontratave të realizuara, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të shërbimeve me vlerën totale Minimumi 400,000.00 euro Auto Europa Cars sh.p.k. & N.T.SH. Europa-Bastri Ademi B.I. ka ofertuar me Listen e Kontratave, kontratat e përfunduara dhe Referencat për secilin kontratë të përfunduar mbi vlerën e kërkuar në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë në vlerë prej 433,996,75 euro. Pra Lista e kontratave të përfunduara është mbi vlerën e kërkuar. Është e pa qart se si Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me kriteret e Njoftimit Për Kontratë dhe të dosjes së tenderit. Në letren standarde ceket që nuk e arrini vlerën e kontratave të realizuara gjatë 3 vitet e fundit mirpo për qudi nuk e specifikon se cila kontratë apo referenc nuk është e pranueshme. Dëshmi e keni në fajllin numer 4 pra: 4.Lista e Kontratave, kontratat dhe Referencat 2025.pdf.

Pra kjo Listë e kontratave është e dorëzuar me ofertë .N.T.SH. Europa ka përfunduar pikërisht kontratën me Autoritetin e Juaj dhe fatura e fundit e pranuar nga Menagjeri i Kontratës së përfunduar është më datën 02.06.2025 dhe fatura e pranuar nga Menagjeri i Kontratës ka numer 6.2025/5 . Kjo fatur mund të verifikohet edhe në ATK Provë;

Pra me këtë faturë edhe ka përfunduar kontrata e nënshkruar ndërmjet N.T.SH. EUROPA-Bastri Ademi B.I. dhe MMPHI-së Vlenë të potencohet se sipas LPP-së dhe Rregullore Nr.002/2024 për Plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik menagjeri i kontratës është përgjegjës për pranimin e faturave dhe lëshimin e Certifikatave apo Referencave Provë: faqe 29 e Rregullore Nr.002/2024 për Plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik Përgjegjësitë e Menaxherit të Kontratës 70.24 Funksionet e menaxherit të Projektit/kontratës janë: 1. Të lëshojë Certifikatat e nënshkruara për dorëzimet (Certifikatën e përkohshme/të përhershme). Andaj ne kemi pranuar Referencën e përfunduar për kontratën me titull: Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare të MMPHI-së (ish MMPH) nga MMPHI në vlerë prej 199,999.00 euro nga Menagjeri i kontratës ku në referenc në mënyrë deqizive ceket citoj:

Pra Njoftimi për kontratë ka qenë data 05.06.2025 dhe referenca e përfunduar është më datë 05.06.2025 edhe pse kontrata ka përfunduar realisht sipas dëshmisë së faturave më 02.06.2025 . Kërkojm që të gjitha referencat e dorëzuara nga N.T.SH. Europa të pranohen si të përfunduara. Edhe Sipas Interpretimit të KRPP-së shuma e realizimit të kontratës duhet të mirret për baz 3 vitet e fundit dhe shuma e relizimit të 3 vitet te fundit duhet të mirret e gjitha në konsiderat: Provë: 10. 22.11.2022 Kurdo që kërkohet në FDT të Dosjes së Tenderit dhe në Njoftim për Kontratë "Lista e kontratave të realizuara (përfunduara) në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë", gjatë vlerësimit të tenderëve, a duhet të merret për bazë totali i vlerës së kontratës apo duhet të përpjesëtohet? Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron interpretimin ligjor si në vijim: Sa i përket dëshmime të kërkuara nga Autoritetet kontraktuese në FTD të Dosjes së tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë në lidhje me Aftësitë teknike dhe/ose profesionale, paragrafi 4.2 i nenit 69 të këtij ligji përcakton: 4.2 listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin; (i) kur shërbimet janë siguruar për autoritetin publik në Kosovë ose në vendin tjetër, si dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve do të shërbejë kopja e certifikatës (certifikatave) përkatëse të lëshuar ose bashkë nënshkrura nga autoriteti i tillë publik; (ii) kur shërbimet janë siguruar për blerësin privat, dëshmi për këtë sigurim të shërbimeve duhet të jetë kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i sigurimit të tillë; Në kuptim të nën-paragrafit 4.2 të nenit 69 të lart cituar, AK në rast se kërkon dëshminë - Listën e kontratave të realizuara në tri vitet e fundit, (nga data e njoftimit për kontratë) kjo do të thotë që kontratat e kërkuara nga AK, duhet të jenë të realizuara (jo në realizim e sipër) pra të përfunduara brenda tri viteve të shkuara nga data e njoftimit për kontratë. Pra për bazë duhet të merret periudha e përfundimit jo e fillimit të kontratës. Për më shumë, kjo do të thotë se në këtë listë duhet të saktësohen të gjitha informatat e hijezuara në këtë nën-paragraf: Llojin e shërbimeve, shumën e kontratës që nënkupton totalin e përgjithshëm të kontratës, datën dhe pranuesin. Si rrjedhojë, gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve në përputhje me dispozitën e lart cituar duhet të merret për bazë shuma totale e kontratës së specifikuar në listë dhe jo të përpjesëtohet. Shembull: Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të ketë të paktën 3.000.000 euro kontrata kryesore të rëndësishme të shërbimeve

të realizuara në periudhën e shkuar tri vjeçare nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Dëshmia dokumentare 1: Lista e kontratave kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar tri vjeçare duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin. Në rast se kërkesa e kontratave të realizuara në periudhën e shkuar tri vjeçare nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë i referohet së bashku një totali prej 3,000,000 euro në tri vitet e fundit dhe operatori ekonomik ka realizuar (përfunduar) një kontratë tri vjeçare t në vlerë prej 3,000,000 euro (kontrata e cila ka filluar dy vite më herët), konsiderohet se OE ka përmbushur kërkesën minimale vetëm me atë kontratë. Kushti minimal është përmbushur duke prezantuar dëshminë Listën e kontratave të realizuara së bashku në total prej 3,000,000 euro në tri vite dhe nuk ka rëndësi se kontrata ka filluar dy vite më herët.

PRETENDIM ANKIMORE 2 Në dosje të tenderit të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale kërkohet: c. Pajisje për mbushjen e klimave (mbushje me gaz 134A 3. Dëshmi Nuk ka dëshmi C për këtë pikë të dosja e tenderit se me qka duhet dëshmuar por vetëm për piken A. Provë: 3. Dëshmi a. Vinça hidraulik për ngritjen e automjeteve, minimum pes (5) vinça. (Të dëshmohet me fotografi) b. Aparatin për mbushjen e klimave AC minimum një (1). (Të dëshmohet me fotografi dhe dud ose fature të blerjes a. Aparatin për mbushjen e klimave AC minimum një (1). (Të dëshmohet me fotografi, dud ose fature. d. Pajisje origjinale për diagnostikimin e veturave, e cila përdoret për automjetet e MMPHI-s. (Të dëshmohet me fotografi) Pajisje për demontimin dhe ballansim gomave minimum një (1). Të dëshmohet me (fotografi) Pra të dëshmia të ky kriter nuk ka pikë c. Megjithatë ne kemi ofertuar me 2 lloje të klimave 1234 YF dhe 134 A Provë fajlli nr 7..NBUSHJA E KLIMES PAISJE 1234 YF ME FATUR 2024.pdf 8.Paisje për mbushjen e klimes 134 A.pdf Në fajllin 8 kemi dorëzuar faturë ashtu si ka ofertuar edhe OE i rekomaduar për kontratë nga i njëjti Furnitor pra paisjen për mbushje të klimes 134 A mirpo për qudi AK-ja e merr si të pranueshme faturen e tyre ndërsa të konzorciumit tonë jo.Ne po ashtu kemi dorëzuar edhe një foto të paisjes së klimes 134 A e që AK-ja konform nenin 72 të LPP-së fare nuk ka kërkuar informata shtesë nese ka pasur pa qartësi edhe pse dëshmit kanë qenë dhe janë të qarta. Në dosje të tenderit të kriteret e dosjes së tenderit është kërkuar citoj: 6. OE duhet të ketë servis të vetin apo të marrjes me qera me së largu 15 km nga Objekti I MMPHI Vërejtje Autoriteti Kontraktues do të dalë në teren dhe do të verifikoj paisjet e ofertuara Komisioni për vlerësimin e tenderëve fare nuk ka dalë në teren për verifikimin e paisjeve e që bie në kundërshtim me dosjen e tenderit të publikuar nga vet AK-ja. Është për habi nga AK-ja pasi që N.T.SH. EUROPA ka përfunduar kontratë pikërisht me MMPHI-së dhe pikërisht me këto paisje ka kryer edhe shërbimet e mbushjes së klimave të veturave të MMPHI-së Ne ju sigurojmë që kemi ofertuar konform kriterëve të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Andaj kërkojmë që ky pretendim ankimor të merret si i bazuar. **PRETENDIM ANKIMORE 3 KUNDER OE TË REKOMANDUAR PËR KONTRATË** Ne më 11.09.2025 pasi që na u është lejuar qasja konform LPP-së kemi hasur në disa parregullësi të OE i rekomanduar për kontratë ku komisioni i vlerësimit të ofertave me dashje ose pa dashje nuk ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar dokumentacionin e OE Gani Krasniqi B.I. Në dosje të tenderit është kërkuar citoj: OE të jetë i certifikuar me ISO 9001 2015 – Menaxhimi i Cilësisë për shërbimet e Servisimit para publikimit të njoftimit për kontratë dhe të ketë linkun për verifikim Certifikata me të cilin ka ofertuar OE ka numer SCC/INT/2401GB/4285 dhe ka linkun për verifikim: <https://qfscerts.com/cert-details.html?subject=SCC%2FINT%2F2401GB%2F4285> Është e quditshme se si AK-ja vet kërkon kriteret të cilat nuk i verifikon .Kjo Certifikat është e pavlefshme (FALLS) pasi OE nuk ka vazhduar vlefshmërinë e saj pra është me skadenc .Pra kjo Certifikat ka vlejtur deri më 16.01.2025. Para datës së publikimit për kontratë, para dorëzimit të ofertave dhe në momentin e dorëzimit të ofertave Certifikata është e skadune. Provë:

Pra kjo dëshmi është e verifikune nga Sistemi Online i vlefshmërisë së Certifikatave. Në këtë pikë kërkojm nga OSHP-ja të veprojm konform nenin 99.2 të LPP-së.

dhe nenit 67.9 të Rregullores Për Prokurimi Publik nr.002/2024 për diskualifikim nga pjesmarrja në këtë aktivitet të prokurimi pasi OE i rekomanduar për kontratë ka paraqitur dokument të rrejshëm dhe të falsifikuar. **PRETENDIM ANKIMORE 4 KUNDER OE TË REKOMANDUAR PËR KONTRATË** Konsiderojm që AK-ja ka shkelë serish nenin 59 të LPP-së duke mos e vlerësuar krahasuar dhe ekzaminuar dosjen e tenderit të OE të rekomanduar për kontratë. Në dosje të tenderit është kërkuar citoj: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale a. Vinqa Hidraulik për ngritje te automjeteve minimum (5) Pas qasjen në dokumente më 11.09.2025 kemi hasur sërish edhe në këtë pikë ku ka bërë kamuflazh OE i rekomanduar për kontratë dhe Komisioni i Vlerësimit i AK-së sërish me dashje ose pa dashje ka vlersuar gabimisht dokumentacion e OE të rekomanduar për kontratë në këtë pikë. OE ka ofertuar me 4 vinqa hidraulik për ngritje të automjeteve provë:

Dëshmi 2 në këtë pikë:

Pra në këtë faturë janë 4 vinqa në kundërshtim me dosjen e tenderit.

OE i rekomanduar për kontratë ka dashur me qëllim që të vë në konfuzitet AK-në dhe komisionin e vlersimit me disa foto të tjera të objektit i cili nuk ekziston fare:

Pra nga fotot e objektit të vjeter (pra dallim tavani objekti i vjeter dhe i ri) mund ta verifikoni edhe ju nga tavani dhe këtu mund të shihet se janë 4 vinqa dhe 1 regllazh. Me Sinqeritetin më të madhe ju sigurojm dhe garantojm që në momentin e dorëzimit të ofertave.

Pra kjo fatur me të cilin e ka pranuar AK-ja si vinq hidraulik është skandal në vete e cila meriton të hetohet edhe nga organet e hetuesis. Si ka mundësi vinquat 4200 kg të kushtojn 2700 euro copa Ndërsa vinqi 3500 kg të kushtoj 5000 euro copa Edhe në këtë pikë ju garantojm që OE ka paraqitur fallsifikim të dokumentacionit duke e vënë në konfuzitet AK-në dhe duke ofruar Regllazh e duke e cituar si Vinq. Në këtë pikë vlersojmë që AK-ja ka vepruar në kundërshtim me nenin 72 të LPP-së pasi që fare nuk është dashtë të kërkojm informata shtesë pasi që OE i rekomanduar për Kontratë ka ofertuar me 4 vinqa me foto dhe 4 vinqa me faturë dhe qdo ndryshim i kësaj shtesë e vinqave sipas LPP-së është ndryshim i kushtit material. OE i rekomanduar ka oferuar me 4 vinqa me foto dhe 4 vinqa me faturë. Ai pas dorëzimit të ofertave mund ti bëjë edhe 5, 10 apo 20 vinqa mirpo ai është i pa përgjegjshëm në këtë pikë. Në këtë pikë kërkojm nga OSHP-ja të veprojm konform nenin 99.2 të LPP-së dhe nenit 67.9 të Rregullores Për Prokurimi Publik nr.002/2024 për diskualifikim nga pjesmarrja në këtë aktivitet të prokurimi pasi OE i rekomanduar për kontratë ka paraqitur dokument të rrejshëm dhe të falsifikuar. Pra në momentin e dorëzimit të OFERTAVE operatori ekonomik ka ofertuar me 4 vinqa hidraulik dhe është dasht të eliminohet si i pa përgjegjshëm dhe te ish vepru konform nenit 99.2 të LPP-së dhe nenit 67.9 të Rregullores Për Prokurim Publik nr 002/2024. **PRETENDIM ANKIMORE 5 KUNDER OE TË REKOMANDUAR PËR KONTRATË** Në dosje të tenderit është kërkuar citoj: 2. OE-ik duhet te ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon; a) (3 punëtorë) Automekanik b) (1 punëtorë) Inxhinier I mekanikes c) (1 punëtorë) Inxhinier e a) Si dëshmi duhet dorëzuar kontratën per marrëdhënie pune, kopjet e diplomave të shkollës se mesme. b) Për inxhinierin e mekanikes diplomën e fakultetit beqelor të noterizuar dhe kontrate ose parakontrate me punëdhënësin c) Për inxhinierin e elektroteknikes diplomën e fakultetit beqelor të noterizuar dhe kontrate ose parakontrate me punëdhënësin Pasi që na është

lejuar qasja më 11.09.2025 te inxhinieri i elektroteknikes dhe inxhinierin e mekanikë kemi hasur në diploma të pa noterizuara ose më mirë thënë pas kërkesës për marrjen e tyre AK-ja na ka dhënë diplomat të cilat janë të pa noterizura. Andaj kërkojm nga OSHP-ja në këtë pikë ti verifikoj se a janë të noterizuara apo jo. **PRETENDIM ANKIMORE 6 KUNDER OE TË REKOMANDUAR PËR KONTRATË** Po ashtu Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka vendosur çmime manipulative tek përshkrimi i çmimit.

Te vetura Dacia 1.6,1598 cm³, viti 2018 16 Vetura pozicioni numer 81 Kompresori i klimes Ka ofertuar me cmim prej 1232.98 euro. Ky cmim është afro 500% më i shtrenjët se cmimi i tregut Duke marr parasysh që AK-ja ka 16 vetura të tilla i bie që të dëmtohet bugjeti i AK-së në masë të madhe. Pra AK-ja ka shkel rënd nenin 1 dhe 6 të LPP-së ku mjetet duhet të shfrytëzohen në mënyren më efikase dhe transparente dhe ekonomike të fondeve publike. Gjithashtu ka shkel rënd edhe nenin 4 pika 1.c të I RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar) Neni 4 Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit 4.1 Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë obligimet në vijim: a. të luaj rolin aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratave, me theks të veçantë për çmimet, afatet e dorëzimit, sasitë, karakteristikat teknike dhe garancive; b. për aq sa është e mundshme në bazë të rrethanave, të bëhet krahasimi efektiv i kërkesave për pjesëmarrje dhe tenderëve për të përcaktuar avantazhet e tyre relative dhe disavantazhet; dhe c. të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut. Neni 1 Qëllimi 1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla. Provë e keni cmimin ONLINE të komprosorit të klimes për veturen Dacia 1.6,1598 cm³, viti 2018 :

Pikërisht ne si OE pjesmarrë në një aktivitet tjetër jemi cilësuar si i pa përgjegjshëm me Vendim të OSHP-së për çmime të larta

PROVË: Vendimi i OSHP-së 2024/1003 faqe 10 e Vendimit. Provë e nxjerr nga Vendimi: Paneli shqyrtues vleron se OE-ja Bastri Ademi B.I. te përshkrimet e çmimeve ka ofruar disa çmime qe jane dukshem te larta ne raport me ato te çmimet e tregut si shembull; Gome vaji per nyje 45 Euro. Goma vaji diferencial 45 Euro. Riparimi i mororrit sherbimi 550 Euro. Vullkanizimi i gomave dhe gomave të mbrendshme 40 Euro. Ballancimi i Rrotëve të Automjetit 40 Euro. Testimi i bllokut te motorit 445 Euro, andaj ky pretendim konstatohet qe eshte i bazuar. Nga të dhënat e lartëshenuar konstatohet qe oferta e ketij OE konsiderohet e papergjegjshme. Pra në Vendim ceket që për shkak të çmimeve të larta jemi të pa përgjegjshëm. Vlerësojm që ky është një precedent ku ky OE pra Gani Krasniqi B.I. ka ofertuar në disa pozicione afro 500% më lartë se sa cmimi i tregut dhe si i till duhet të cilësohet si i pa përgjegjshëm. Kërkojm nga OSHP-ja edhe në këtë pikë të konstaton duke u bazuar edhe në Vendimet Praprake që OSHP-së 2024/1003 “ashtu siq na ka shpall neve të pa përgjegjshëm” që edhe OE Gani Krasniqi B.I. të shpallet i pa përgjegjshëm për shkak të çmimeve ekstremisht të larta në disa pozicione për njësi. Kundërshtim i Refuzimit të Kërkesës Për Rishqyrtim nga AK-ja E kundërshtojm Refuzimin e AK-së ndaj Kërkesës Për Rishqyrtim pasi që ka bërë vlerësim të gabuar të gjendjes faktike. Edhe njëhere e potencojm qartë që Kontrata Realisht ka përfunduar më 02.06.2025 atëhere kur Menagjeri i kontratës z.Lulzim Zhitija i ka pranuar faturat e fundit provë i keni në pretendimin ankimor 1. Ne

si OE nuk i dim procedurat e brendshme të AK-së ne kemi bërë Kërkesë në e-mail për lëshimin e referencës si në vijim: Provë e-maili zyrtar dërguar Menagjerit të Kontratës:

diskutohet fare por të pranohet si e till pra e përfunduar. Edhe ju vet si AK në refuzim e keni pranuar që e keni pranuar faturen, ku fatura e fundit ka shumën 785 euro pikërisht të dates 02.06.2025 të cilën e kemi dëshmuar në pretendimin ankimor 1. Andaj AK-ja është duke e kundërshtuar vetveten e tyre. Kërkojm që ky pretendim ankimor të pranohet si i bazuar Edhe pretendimin ankimor 2 nuk e ka vlersuar në mënyrë reale . Ne si OE kemi ofertuar me 2 lloje të klimave: 7..NBUSHJA E KLIMES PAISJE 1234 YF ME FATUR 2024.pdf 8.Paisje per mbushjen e klimes 134 A.pdf Në fajllin 8 kemi dorëzuar faturë ashtu si ka ofertuar edhe OE i rekomaduar për kontratë nga i njëjti Furnitor pra paisjen per mbushje te klimes 134 A mirpo për qudi AK-ja e merr si të pranueshme faturen e tyre ndërsa te konzorciumit tonë jo.Ne po ashtu kemi dorëzuar edhe një foto të paisjes së klimes 134 A e që AK-ja konform nenin 72 fare nuk ka kërkuar informata shtes nese ka pasur pa qartësi edhe pse dëshmit kanë qenë dhe janë të qarta. Pra ka mundur të kërkoj dhe ka pasur për obligim nese ka pasur paqartësi të kërkoj informata shtes për paisjen në fjal pra konform fatures të kërkoj dëshmin e fotos apo të dal në teren ti verifikoj paisjet ashtu siq e ka potencuar në DT. Kërkojm që edhe ky pretendim ankimor të pranohet si i bazuar. Edhe pretendimin ankimor 3 nuk e ka vlersuar në mënyrë reale Pra AK-ja në këtë pike ka qenë skandaloze pasi që fare nuk e cek që e ka pasur certifikaten pa validitet pot thot që e ka aktive në sistem online. Vëmendje për PSH dhe Ekspertin Shqyrtues ne si OE pas qasjes kemi hasur në certifikaten ISO e cila ka skaduar më 16.01.2025 të cilat prova i keni në pretendimin 3 mirpo AK-ja ka vepruar në mënyrë të njëanshme duke e pranuar si të mirëqenë edhe pse datën e skadimit e ka më 16.01.2025. Me të Refuzuar Kërkesen Për Rishqyrtim OE i rekomanduar për kontratë e ka shkarkuar refuzimin dhe duke i pare pretendimet ankimore e ka vërejtuar dhe më 17.09.2025 e ka rregulluar pra e ka modifikuar Certifikaten ISO 9001:2015 që është rast për tu hetuar. Natyrisht ne si OE i kemi ruajtur dëshmit edhe në PC tone dhe panelit shqyrtues dhe Ekspertit Shqyrtues ju'a bashkangjesim në CD dëshmit e ruajtura me 15.09.2025 në linkun në vijim: <file:///C:/Users/OnLine/Desktop/QFS%20CERTS%20-%20Clients%2015.09.2055.html> Ne si OE natyrisht që lënden do ta dërgojm edhe në Krimet Ekonomike dhe Prokurorin Speciale për trajtim dhe hulumtim. Ky pretendim ankimor kërkojm të merret si i bazuar pasi që para publikimit për kontratë dhe para dorëzimit të ofertave sipas dëshmime ky OE ka pasur certifikaten pa validitet pra me skadenc. Edhe pretendimin ankimor 4 nuk e ka vlersuar në mënyrë reale E kundërshtojm fuqishëm edhe refuzimin e pretendimin ankimor 4 pasi që OE sipas dëshmime ka ofertuar me 4 vinqa dhe jo 5. Edhe njëhere e potencojm që OE pasi mund ti bëjë 5,6,10 apo 20 vinqa por në oferta ka ofertuar me 4 vinqa me faturë dhe foto provat I keni në pretendimin ankimor 4 më lartë. Ne pasi që kemi kërkuar qasje askund nuk ka pasur prova që komisioni ka dal ne teren për verifikim.Mirpo edhe nese del në teren pas përmbylljes së raportit të velersimit të ofertave OE nese i bënë edhe 10 vinqa nuk duhet merrur për bazë pasi që në ofertë dëshmit I ka të qarta që ka ofertuar me 4 vinqa. Shtohet pyetja se si ka mundësi komisioni i vlerësimit të dal në teren për verifikim të njëri OE dhe tjetri jo edhe pse komisioni i vlerësimit fare nuk ka dal në teren gjatë vlerësimit të ofertave. Kërkojm që ky pretendim ankimor të merret si i bazuar Edhe pretendimin ankimor 5 nuk e ka vlersuar në mënyrë reale Sa i përket pretendimit 5 ne kemi kërkuar që për Inxhinierin e elektroteknikës dhe Mekanikës të verifikohen se ai kanë diplomat e noterizuara pasi që ka qenë kriter I dosjes së tenderit që diplomat të jenë të noterizuara.Ne në qasje nuk i kemi vërejtuar se janë të noterizuara. Andaj kemi kërkuar që kjo pjesë të shikohet. Edhe pretendimin ankimor 6 nuk e ka vlersuar në mënyrë reale E kundërshtojm fuqishëm edhe përgjigjjen në pretendimin ankimor 6 në Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim të cilën AK-ja fare nuk është mundur që ta hulumtoj tregun dhe as ti shikoj provat tona ku OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar në disa pozicione prej 500% më

shtrejt se cmimi I tregut. AK-ja ka shkel rend nenin 4 pika c I RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar: Neni 4 Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit 4.1 Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë obligimet në vijim: a. të luaj rolin aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratave, me theks të veçantë për çmimet, afatet e dorëzimit, sasisë, karakteristikat teknike dhe garancive; b. për aq sa është e mundshme në bazë të rrethanave, të bëhet krahasimi efektiv i kërkesave për pjesëmarrje dhe tenderëve për të përcaktuar avantazhet e tyre relative dhe disavantazhet; dhe c. të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut. Në këtë AK-ja fare nuk është munduar që të sigurohet që çmimi i cili synon të kontraktoj është afër 500% më shtrenjë se çmimi i tregut.

Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka vendosur çmime manipulative tek përshkrimi i çmimit. Te vetura Dacia 1.6,1598 cm3, viti 2018 16 Vetura pozicioni numer 81 Kompresori i klimes Ka ofertuar me çmim prej 1232.98 euro. Ky çmim është afro 500% më i shtrenjë se çmimi i tregut Duke marr parasysh që AK-ja ka 16 vetura të tilla i bie që të dëmtohet bugjeti i AK-së në masë të madhe Pra AK-ja ka shkel rënd nenin 1 të LPP-së ku mjetet duhet të shfrytëzohen në mënyren më efikase dhe transparente të fondeve publike. Gjithashtu ka shkel rënd edhe nenin 4 pika c të I RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK (Versioni i Konsoliduar) c. të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut Kontrata lidhet për çmime për njësi dhe qdo pozicion i saj duhet të analizohet dhe të hulumtohet çmimi i tyre. AK-ja fare nuk e ka marr mundin që të shikoj Vendimin e OSHP-së ku pikërsht për çmime të larta për njësi jemi trajtuar nga OSHP-ja si të pa përgjegjshëm edhe pse kemi qenë brenda vlerës së parashikuar të atij aktiviteti të prkurimit. Provat i keni në pretendimin e 6 ankimor. Nisur nga gjendja faktike dhe nisur edhe nga ato që u thanë me lartë, kërkojmë nga OSHP që të marr: V E N D I M APROHOHET si e bazuar ankesa e OE Auto Europa Cars sh.p.k.&N.T.SH. EUROPABastri Ademi B.I. lidhur me tenderin “Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare të MMPHIsë” i iniciuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës ANULOHEM Njoftimi mbi Vendimin e AK për dhënie të Kontratës i publikuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim. Ri-vlerësimi të bëhet plotësisht duke u bazuar në dispozitat ligjore të LPP-së, kërkesat e dosjes së tenderit dhe që të shpallet fitues Auto Europa Cars sh.p.k.&N.T.SH. EUROPA-Bastri Ademi B.I. si OE më i lirë i përgjegjshëm.

Koha e humbuer në përgatitejn e ofertës,dëmi material për mos marrjen e kontratës,reputacioni i kompanisë etj.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, lidhur me pikat e eliminimit të ofertës suaj, të cilat edhe ju i keni potencuar në kërkesën për rishqyrtim, ju sqarojmë edhe njëherë se nuk i përmbushni kërkesat e përcaktuara në FDT, prandaj edhe jeni eliminuar si ofertë e papërgjegjshme. Referenca e MMPHI-së me numër protokolli 4483/25 të datës 09.06.2025, të cilën ju e keni prezantuar, nuk është lëshuar nga Zyra e Prokurimit. Në këtë rast, vlera që e keni prezantuar në total të referencave, kur hiqet kjo referencë, është vlera e kontratave të realizuara që mbetet 233,997.75 euro, ndërsa kërkesa e AK ka qenë që vlera e kontratave të përfunduara duhet të jetë 400,000.00 euro.

Sa i përket listës së kontratave dhe dëshmive të ofruara në fazën e vlerësimit, si dhe tani fakteve dhe argumenteve që pretendoni se e përmbushni këtë kërkesë, ato nuk qëndrojnë për arsye se

kontrata të cilën ju e keni deklaruar në listën e kontratave dhe dëshminë-referencë vetëm nga menaxheri i kontratës nuk janë të pranuar nga ana e AK, për faktin se kontrata e tillë ende nuk ka qenë e përfunduar me rastin e publikimit të njoftimit për kontratë, gjë të cilën edhe ju në listën e kontratave e keni deklaruar se kontrata në fjalë ka përfunduar me datë (shih dëshmi).

Vlen të theksohet se, në bazë të listës, e keni vendosur emrin e personit përgjegjës të prokurimit, i cili nuk ka qenë në dijeni për lëshimin e një reference që e keni deklaruar në ofertën tuaj dhe e cila nuk vlen si dëshmi e përfundimit të kontratës. Në bazë të dëshmive që i kemi ne si AK, kontrata në fjalë gjatë fazës së tenderimit ka qenë ende në fazën e ekzekutimit të pagesave dhe nuk ka qenë si kontratë e përmbyllur nga ana e AK.

Ndërsa, sa i përket të dhënave të tjera që i keni deklaruar në këtë pretendim ankimor, ato nuk qëndrojnë dhe janë të pavërteta, për faktin se vetë menaxheri i kontratës, me datë 12.06.2025, ka bërë konfirmimin e një fature e cila nga Zyra e Prokurimit është lëshuar për pagesë me datë 19.06.2025. Andaj, edhe referenca e lëshuar nga menaxheri dhe data e deklaruar për përfundimin e kontratës me ato data nuk janë të sakta.

Sa i përket pretendimit se menaxheri i kontratës, në bazë të rregullores, ka të drejtë që të lëshojë certifikatë të përfundimit të punimeve, kjo është e vërtetë, mirëpo në këtë rast menaxheri nuk ka lëshuar certifikatë të përfundimit të shërbimeve, por ka lëshuar referencë, duke e ditur se kontrata ende nuk ka përfunduar. Mbi të gjitha, menaxheri i projektit në institucionin tonë asnjëherë më parë nuk ka lëshuar referenca, sepse është rregull i brendshëm që referencat lëshohen nga ZPP dhe konfirmohen nga ZKA.

Sa i përket pretendimit ankimor lidhur me pajisjen mbushëse të klimave, në kërkesë të AK, një kërkesë e tillë ka qenë që OE duhet të ofrojë dëshmi, citojmë kërkesën:

“c. Pajisje për mbushjen e klimave (mbushje me gaz 134a) dhe si dëshmi është kërkuar: a. Aparatin për mbushjen e klimave AC minimum një (1) (të dëshmohet me fotografi, DUD ose faturë).”

Sqarojmë më tej se ju, si OE, në ofertën tuaj për këtë pikë keni dorëzuar foto dhe faturë të cilat nuk përputhen dhe, në të njëjtën kohë, nuk e përmbushin kërkesën e lartpërmendur. Më tej paraqesim mospërputhjen ndërmjet fotos për pajisjen dhe faturës së dorëzuar. Andaj, pretendimi juaj ankimor është i pabazuar.

Sa i përket certifikatës ISO, pretendimi nuk qëndron, pasi që në dokumentacionin e prezantuar nga OE i rekomanduar, certifikata në fjalë është me afat validiteti. Edhe pas verifikimit në ueb-faqen e entitetit në fjalë, del se është aktive. Për çdo dyshim tjetër, ju mund t'i drejtoheni organeve përgjegjëse.

Lidhur me këtë pretendim ankimor bëjmë të ditur se OE ka dorëzuar foton konform kërkesës së FDT pika 3. Përtej kësaj, Komisioni i Vlerësimit ka kërkuar sqarime dhe i njëjti është përgjigjur konform kërkesës, si dhe ka ofruar dokumentacion sqarues/shtesë se plotëson këtë kërkesë. Po ashtu, Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka bërë vizitë te OE i rekomanduar për kontratë dhe ka verifikuar se OE posedon gjithsej 8 vinça.

Sa i përket stafit profesional, ai është si vijon:

a) 3 punëtorë automekanikë;

- b) 1 punëtor inxhinier i mekanikës;
- c) 1 punëtor inxhinier i elektroteknikës.

Si dëshmi duhet të dorëzohen kontratat për marrëdhënie pune dhe kopjet e diplomave të shkollës së mesme. Për inxhinierin e mekanikës kërkohet diploma e fakultetit beqar (bachelor) e noterizuar dhe kontratë ose parakontratë me punëdhënësin. Për inxhinierin e elektroteknikës kërkohet diploma e fakultetit beqar (bachelor) e noterizuar dhe kontratë ose parakontratë me punëdhënësin.

Sipas kërkesës së lartpërmendur, në asnjërën pikë nuk kërkohet noterizimi, ashtu siç është e ndaluar edhe me legjislacionin në fuqi. Përtej kësaj, sqarojmë se për stafin e lartpërmendur OE i rekomanduar për kontratë ka bashkëngjitur edhe noterizimin, edhe pse AK nuk e ka kërkuar një gjë të tillë në FDT, duke respektuar dispozitat ligjore.

Pas shqyrtimit të këtij pretendimi ankimor, AK ka përzgjedhur procedurën e shpërblimit të kontratës me tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët të poentuar. Arsyeja e poentimit vjen në rastet kur kufizohet që OE-të të ofrojnë me çmimet e tregut. Vlera e përgjithshme e ofertës është brenda vlerës së parashikuar të kontratës.

Ky pretendim ankimor refuzohet si i pabazuar.

Kërkesa juaj për rishqyrtim refuzohet si e pabazuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 07.10.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/0954, ndërsa me datë 23.10.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0954. Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues ndërsa OE është pajtur lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashitësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashitësit dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Auto Europa Cars SH.P.K., ekspertit shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0954, ka vlerësuar si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Lidhur me pretendimin nr. 1, Paneli shqyrtues konstaton se Njoftimit për Kontratë (NJK) dhe Dosjes së Tenderit (DT), të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, kërkesa nr. 1 është kërkuar: 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses se paku 1 kontratë për shërbime të njejta, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë) minimum 400,000.00 euro. si **Dëshmia e kërkuar dokumentare:** është kërkuar “1.Një listë të kontratave të realizuara, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të shërbimeve me vlerën totale Minimumi 400,000.00 euro. PSH sqaron se OE-ja ankuesi në ankesën e paraqitur në OSHP ka prezentuar Listen e kontratave se bashku me referenca, po ashtu edhe kërkesën për lëshimin e references drejtuar menaxherit të kontratës (data 09.06.2025). Në këtë procedurë publikimi i Njoftimit për kontratë është publikuar në platformën e-prokurimit nga ana e Autoritetit Kontraktues është me datë 05.06.2025. Operatori ekonomik ankues me datën 09.06.2025 parashtrone kërkesën përmes emailit të menaxherit të kontratës të lëshojë reference për kontratën e përfunduar. Referenca e lëshuar nga menaxheri i kontratës përmban vulën e protokollit (arkives) të datës 09.06.2025,(datën e kërkesës të drejtuar nga OE-ja ankues të menaxherit të kontratës), Po ashtu në listen e kontratave të dorëzuara nga OE ankues, deklaron se data e përfundimit të kontratës është me 09.06.2025, datën e lëshimit të references. Duke u bazuar në UDHËZUES NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, citohet; Në të gjitha rastet e përfshira në 2.1, 4.2 dhe 6.2 të nenit 69 të LPP-se përmendet shprehja si në vijim citojmë: “ të realizuara (përfunduara) në tri vitet e shkuara “ose “ në periudhën e shkuar trevjeçare...”). Në kuptimin e Ligjit shprehja “tri vitet e shkuara” nënkupton: “ periudhën kohore të përcaktuar në këto nene e cila ndërlidhet me periudhën që paraprinë datën e publikimit të njoftimit për kontratë ose, në rast të procedurave të negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës, dërgimin e ftesës për pjesëmarrje ose tenderim. Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues konstaton se sipas kërkesës drejtuar MMPHI-se për lëshim të

referencës është e dates: 09.06.2025 (kërkesa e bashkangjitur pjesë e ankesës) referenca e lëshuar nga ana e menaxherit të kontratës sipas dates së prokuratore është tri ditë pas publikimit të Njoftimit për Kontratë në prokurim. Po ashtu PSH sqaronë se kjo është në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së, kërkesa për lëshimin e referencës është bërë me datë 09.06.2025, dhe përmban vulën e protokollit (arkivës lëshimit) të njëjtës date. PSH konstaton se Referenca e lëshuar nga AK-ja është. Evidentuar vetëm një nënshkrim ndërsa sipas AK-se thuhet se është nënshkruar vetëm nga menaxheri i kontratës nga AK MMPHI , dhe se në referencë thuhet se ka përfunduar me sukses kontratën , ndërsa ZPP-i AK-se i cili ka qenë edhe nënshkruar i kontratës sikurse ky aktivitet për të njëjtin AK, deklaron se nuk është përfunduar kontrata në tërësi . Sipas referencës vlen protokollit është e datës: 09.06.2025, ndërsa në referencë citohet zyra e prokurimit dhe menaxheri i kontratës, ku AK sikurse në vendimin për rishqyrtim dhe në përgjigjen e raportit të ekspertës shqyrtues citon se dëshmia e referencës është vetëm nga menaxheri i kontratës dhe se kontrata nuk ka qenë e përfunduar me rastin e publikimit të Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave në tërësi dhe argumenteve të prezentuara nga ankuesi mund të konkludohet se AK me të drejtë ka eliminuar ankuesin nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit, pasi që Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nga OE-ja ankues nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës së përcaktuar në NJF dhe DT. Po ashtu PSH sqaronë se OE-ja në Listën e kontratave të dorëzuar në oferte paraqet se lëshuesi i referencës është zyrtari kryesor ZPP, i njëjti

konfirmon se nuk ka lëshuar referencë, dhe nuk është në dijeni të kësaj referencë ku sipas përgjigjes së AK-se citoj “

Sa i përket listës së kontratave, dëshmi të ofruar në fazën e vlerësimit si dhe tani faktet dhe argumentet të cilat pretendon se e përmbushen këtë kërkesë nuk qëndrojnë për arsye se projektin të ju e keni deklaruar në listën e kontratave dhe dëshmi referencë vetëm nga menaxheri i kontratës nuk janë të pranuar nga ana e AK për faktin se kontrata e tillë ende nuk ka qenë e përfunduar me rastin e publikimit të Njoftimit për Kontratë gjë të cilën edhe ju në listën e kontratave e keni deklaruar se kontrata në fjalë ka përfunduar me datë shih dëshmi,

Lidhur me pretendimin 2 për çka AK -ja ka eliminuar OE ankues lidhur me Aparatin për mbushje të klimave (Mbushjen me gaz 134 A) .Në Njoftimin për Kontratë dhe Dosje të tenderit tek Kërkesat mbi mundësitë teknike/ profesionale është kërkuar pika c. Pajisje për mbushjen e klimave (mbushje me gaz 134A), tek B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara: 14.08.2025 dëshmi : (Të dëshmohet me fotografi, dëd ose faturë), poashtu edhe në sqarimet e kërkuara përgjigjet në kërkesat për informacionet shpesh të dates: 25.06.2025 në përgjigjen nr 3 ku citohet “ *Duke u bazuar në sasinë e veturave dhe llojllojshmerin e tyre si AK kemi parapare pajisjet e nevojshme të cilat ju përshtaten llojit të veturave të cilat janë në listën e çmimeve .Pajisjet për klima i kemi kërkuar dy lloje pasi që disa vetura mbushen me njërin pajisje dhe me tjetren jo dhe e kundërta. Është e domosdoshme që OE të kenë të gjitha pajisjet e kërkuara në dispozicion të AK-së”* .

AK-ja ka potencuar se, OE në ofertën e tij ka ofruar Aparatin për mbushjen e klimave duke ja bashkangjitur faturën tatimore nr 1204 të datës: 17.12.2021, me përshkrim Arizona maquina për klimë, dhe poashtu ka ofruar edhe dy foto pjesë të faturës fjalë nr 8 me përshkrim Pajisje për mbushjen e klimes 123 A. Sikurse ka përshkruar në pretendimin ankimor. Poashtu dhe në ankesën e deponuar pran OSHP-se , OE-ja ankues ka pretenduar se posedon këtë pajisje për mbushje të klimes, ku ka cituar me pasusin: “*Në fajllin 8 kemi dorëzuar faturë ashtu si ka ofertuar edhe OE i rekomaduar për kontratë nga i njëjti Furnitor pra pajisjen për mbushje të*

klimes 134 A mirpo për qudi AK-ja e merr si të pranueshme faturen e tyre ndërsa te konzorciumit tonë jo. Ne po ashtu kemi dorëzuar edhe një foto të paisjes së klimes 134 A e që AK-ja konform nenin 72 të LPP-së fare nuk ka kërkuar informata shtesë nese ka pasur pa qartësi edhe pse dëshmit kanë qenë dhe janë të qarta". PSH ka anaizuar faturat tatimore nga i njëjti furnitor dhe fotot të prezentuara sikurse të OE ankues dhe OE i rekomanduar për kontratë nga AK-ja, dhe përveq ndryshimit të evidentuar në fotografit e deponuara , ne faturen e OE ankues nuk ka pershkrim e njëjte , tek OE ankues ka pershkrim : art nr. 000091 Arizone maqine për klime , ndersa OE i rekomanduar art nr 000092 Maqine për Klima Arizona 5001.

Paneli Shqyrtues për të vërtetuar eliminimin e OE ankues nga AK-ja për mos përmbushje të kësaj kërkesë dhe duke aplkuar nenin 105 ku citohet “ *paragrafi 2.3. ku citohet “ t’i japin urdhër çdo personi, ndërmarrje ose autoriteti publik duke kërkuar nga një person, ndërmarrje ose autoritet i tillë që të dorëzojë, bartë, paraqesë dhe/ose mundësojë qasje në të dhëna, informacione, dokumente (përveç këshillave të privileguara juridike), dhe/ose artikuj të tjerë të pasurisë së luajtshme dhe/ose të paluajtshme që paneli shqyrtues, në ushtrimin e arsyeshëm të diskrecionit të vet, i konsideron të rëndësishme për zbatimin e hetimeve ose të procedurave për shqyrtimin e prokurimit “*, dhe nenin 116 paragrafi 3 citoj “ *3. Para marrjes së një vendimi përfundimtar mbi një çështje, OSHP mund të kërkojë nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë. OSHP ka të drejtë që të kërkojë nga çdo person, ndërmarrje ose autoritet publik që të dorëzojë materiale ose dëshmi që me arsye mendon se kanë të bëjnë me çështjen përkatëse. Ngjashëm, OSHP ka të drejtë që të kërkojë nga çdo person, ndërmarrje ose autoritet publik që të sigurojë dëshmi që paneli shqyrtues me arsye mendon se kanë të bëjnë me çështjen përkatëse*”. me datën 11.11.2025 dhe 13.11.2025, përmes e-mailit oshp@rks-gov.net , drejtuar lëshuesit të faturës sipas e-mail adreses së vendosur në fatur :tehnoauto10@gmail.com, duke kërkuar informacion citoj “ *Luteni të konfirmoni se Aparati- maqina per klima i prezentuar në foto dhe faturen tatimore nr 1204 të datës: 17.12.2021 me pershkrim Arizona maqina per klime nga Operatori Ekonomik N.T.SH EUROPA se a është i konpanise tuaj : P.U.T. TehnoAuto Prizren , dhe a është Aparat -maqin për klima sipas modelit 134A . Të bashkëlidhur gjeni faturen dhe fotot e aparatit. Në e-mailin nga OSHP-ja është informuar; Rikujtim : Ofrimi i të dhënave jo të vërteta , është e denushme sipas Kodit Penal.*

Me datën 13.11.2025, kemi pranuar e-mailin ku citohet “ **Fatura 1204 është realizuar sipas datës ne fajli . Maqina ne foto nuk i perket modelit i fatures ne fjali**”. Nga këto të gjetura konstatohet se AK-ja ka vepruar sipas LPP-se , në mos përmbushje të kësaj kërkesë , ngase OE ankues ka ofruar faturen duke ja bashkangjitur fotografit e klimes e qe është konstatuar se aparati i paraqitur ne foto per modelin Aparatin per mbushje te klimave (Mbushjen me gaz 134 A) nuk i perket faturës së bashkangjitur .

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, konstatone se OE ankues nuk ka ofruar Pajisje për mbushjen e klimave mbushje me gaz 134A, ashtu siq është kërkuar ne NJF dhe DT, si dhe ne pergjigjet ne sqaimet e kërkuar . Po ashtu konstatohet se OE-ja ankues ka bërë paraqitjen e të dhënave prezentuar pajisje qe nuk i perket kompanis në fjal. Lidhur me pretendimin nr. 3, Paneli Shqyrtues konstaton se kjo bie mbi përgjegjësin e Autoritetit Kontraktues, po ashtu vlene te theksohet fakti se AK-ja lidhure me këtë pretendim te certifikates ISO 9001 2015, conform LPP-së nenit 52 paragrafit 7 ku citohet 7. Autoriteti kontraktues në rast të dyshimit të cilido informacioni të dorëzuar nga operatori ekonomik, do të kryejë një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit. AK-ja Ka bërë kontroll efektive te dokumentiti ISO 9001-2015 te OE-së se rekomanduar për

kontratë, dhe ka verifikuar qe certifikata është valide. Gjitashtu paneli sqarone, pas vlerësimit dhe administrimit të të gjitha provave përkitazi me këtë pretendim kemi bërë kontroll te certifikates ISO permes webfaqes www.qfscerts.com, dhe është verifikuar se certifikata është aktive.

Lidhur me pretendimin nr. 4, Paneli shqyrtues sqarone se Njoftimit për Kontratë (NJK) dhe Dosjes së Tenderit (DT), te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, kërkesa nr, 3, pika a, është kërkuar, a. Vinça Hidraulik për ngritje te automjeteve minimum (5). si Dëshmia e kërkuar dokumentare: është kërkuar Vinça hidraulik për ngritjen e automjeteve, minimum pes (5) vinça. (Të dëshmohet me fotografi). PSH konstaton se ekspertja shqyrtuse në këtë pike ka qene jo profesionale, për arsye se ne NJF dhe DT është kërkuar qe Vinça Hidraulik për ngritje te automjeteve të dëshmohet me fotografi. OE-ja i rekomanduar për kontratë ka ofruar dy fotografi si dëshmi, ku ne dy fotografi i ka prezentuar nga 4 vinça hidraulik, gjithsej i bien 8 vinça. Po ashtu sqarojm se AK-ja me datë 05.09.2025 konform nenit 59 paragrafit 2, dhe neni 72 ka kërkuar sqarim nga OE-ja i rekomanduar për vinçat hidraulik, dhe i njeiti është përgjigjur conform kërkesave, gjithashtu theksojm se AK-ja, sqarone se komisioni i vlersimit ka bërë një vizite te OE-ja i rekomanduar për kontratë dhe ka verifikuar se i njeiti posedon 8 vinça hidraulik. Konform nenit 59 paragarfi 1 komision i vlerësimit brenda AK-së, i cili supozohet të jetë profesional dhe të ketë përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës, bazuar në nenin 59 paragrafi 1 të Ligjit për Prokurim Publik (LPP-së). PSH sqarone duke u bazuar edhe ne nenin 56 paragrafin 3 i LPP-së Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Po ashtu edhe RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve, paragrafi 40.12 Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit. Dhe nuk mund te merret si pretendim ankimore kërkesat që nuk janë paraparë ne NJK dhe DT-në , siq parashihet me LPP-në neni 56, paragrafi 3.

Lidhur me pretendimin nr. 5 Paneli Shqyrtues konstaton se se Njoftimit për Kontratë (NJK) dhe Dosjes së Tenderit (DT), te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, kërkesa nr, 3, është kërkuar, si Dëshmia e kërkuar dokumentare a) Si dëshmi duhet dorëzuar kontratën per marrëdhënie pune, kopjet e diplomave të shkollës se mesme. b) Për inxhinierin e mekanikes diplomën e fakultetit beqelor të noterizuar dhe kontrate ose parakontrate me punëdhënësin c) Për inxhinierin e elektroteknikes diplomën e fakultetit bechelor të noterizuar dhe kontrate ose parakontrate me punëdhënësin, Paneli vëren se lidhur me këto pretendimet ankimore janë analizuar nga ana e ekspertit në mënyrë të detajuar, të kuptueshme dhe të bazuara në dokumentacione të ofruara për këtë aktivitet të prokurimit dhe ashtu sikurse kërkohet me nenin 113 dhe 114 të LPP dhe pajtohet me konstatimet e ekspertit pa nevojë që ato tani, sërish të përfshihen dhe/ose përshkruhen në këtë rast, kështu që, pretendimet ankimore të ankuesit kundrejt OE të rekomanduar për kontratë janë të pa bazuara. Po ashtu Paneli shqyrtues pas shqyrtimit te diplomave te prezentuara per inxhiniera nga OE-ja i rekomanduar konstatone se OE ka dorzur diplomat te noterizuar te inxhinierave konform NJK dhe DT-së. Pas analizimit të pretendimit ankimor, dhe krahasimit te dokumentacionit te OE-së rekomanduar për kontratë vlen te theksohet, se edhe diplomat e shkollës mesme per automekanik ka dorzuar te noterizuar.

Lidhur me pretendimin nr. 6 Sa i përket këtij pretendimi Paneli Shqyrtues, konstaton se nuk qëndron ky pretendimi i OE ankues për faktin se OE-ja ankues nuk ka ofruar ndonje prove duke

prezentuar ndonjë dëshmi për çmimi qe janë me te larta se tregut, te dëshmoje me ndonjë fatur, profatur ofertë për çmimet e tregut , dhe bazuar në nenin 4 të RrPP-se . Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit, par 4.1 Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë obligimet në vijim: c. të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut.

Rrjedhimishtë, nga gjithë të gjenturat e lartëcitura , dhe në mbështetje të nenit 1 dhe 7 të LPP-së, Paneli Shqyrtues ka vendur ta lë në fuqi B58 Njoftim mbi vendin e AK-se''', lidhur me aktivitetin e prokurimit Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare të MMPHI-së me numër të prokurimit 210-25-4970-2-1-1.

-Përfundim-

Paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK dhe të vazhdoj tutje me fazën tjetër të këtij aktiviteti të prokurimit, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional dhe po ashtu përgjegjës sipas nenit 59.1 cituar "Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës". Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK konform nenit 24 paragrafi 2 të LPP cituar'' Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj''.

Paneli shqyrtues thekson faktin se Autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji''. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor**
- **OE - Auto Europa Cars SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: